Kronikë

U raportua si aksident, zbardhet sherri në Lezhë! Arrestohet i riu që kërcënoi me armë 23-vjeçarin, u përplas me një makinë kur po largohej! 3 në kërkim

Një ngjarje e raportuar thjesht si aksident mbrëmjen e së premtes (24 mars), ishte në fakt sherr mes të rinjve që përfundoi në kërcënime me armë zjarri. Për pasojë është arrestuar një 20 vjecar Anteo Fizi dhe janë shpallur në kërkim 2 shokët e tij, Kristjan Gjergji dhe David Doda bashkë me 23-vjecarin Ednant Lulaj që u kërcënua.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
27 Mars, 13:20 | **Përditesimi: 27 Mars, 13:40**

Share

LEZHË – Një ngjarje e raportuar thjesht si aksident mbrëmjen e së premtes (24 mars), ishte në fakt sherr mes të rinjve që përfundoi në kërcënime me armë zjarri. Për pasojë është arrestuar një 20 vjeçar Anteo Fizi dhe janë shpallur në kërkim 2 shokët e tij, Kristjan Gjergji dhe David Doda bashkë me 23-vjeçarin Ednant Lulaj që u kërcënua.

Mbrëmjen e së premtes, poshtë mbikalimit të Ishull lezhës, Anteo Fizi që shoqërohej nga 2 shokët kërcënoi Ednant Lulajn. Pasi 3 djemtë e kërcënuan me armë zjarri, u larguan me shpejtësi dhe u përplasën me një tjetër makinë me drejtues shtetasin M. K.

LEXO EDHE:
Shpërthimi në 2020 në pallatin në ndërtim të biznesmenit Liman Gjoka në Lezhë, në pranga porositësi

Policia njofton se ky rast është trajtuar fillimisht si aksident rrugor, por si rezultat i informacioneve të grumbulluara në vendngjarje, janë thelluar hetimet dhe si rezultat i tyre, është zbardhur dinamika.

Në vijim të veprimeve procedurale, shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë arrestuan në flagrancë shtetasin Anteo Fizi, 20 vjeç, banues në Lezhë, si dhe shpallën në kërkim Kristjan Gjergji, 24 vjeç, banues në Rrilë dhe David Doda, 23 vjeç, banues në Barbullojë.

Gjithashtu, për këtë rast, u shpall në kërkim shtetasi Ednant Lulaj, 23 vjeç, banues në Tale, i cili nuk ka kallëzuar se është kanosur me armë zjarri, nga 3 shtetasit e lartpërmendur.

Vijon puna për kapjen e 3 shtetasve të shpallur në kërkim, si dhe në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vijojnë hetimet për dokumentimin e plotë ligjor të përgjegjësisë penale të secilit prej shtetasve të përfshirë në këtë rast.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

A.M./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Ednant lulaj | David Doda | Kristjan Gjergji | Anteo Fizi | Lezhe

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kush mendoni se qëndron mbrapa sulmit ndaj Top Channel?

Pronarët sherr | Investigimet | Lufta politike

Lajme të tjera

Tentuan të vrisnin të riun në Rreshën, arrestohet një prej autorëve! Në kërkim i biri dhe nipi
27 Mars, 15:51

Tentuan të vrisnin të riun në Rreshën pas një sherri mes dy djemve, arrestohet një prej autorëve, i biri dhe nipi ende në kërkim! Makina e blinduar i shpëtoi jetën të riut
27 Mars, 10:01

'Drekë 100% Made in Albania', Presidenti i Austrisë drekon tek mrizi i zanave në Fishtë të Lezhës
26 Mars, 21:33

Konflikti mes fiseve, plumba makinës së blinduar të nipit të Kastriot Reçit në Rrëshen! Pasi u qëllua i riu përplaset me bordurën e rrugës, në kërkim babë e bir
26 Mars, 20:13

Del FOTO nga aksidenti në Kurbin, makina e kthyer përmbys ka përfunduar në arë, humb jetën shoferi
26 Mars, 09:57

Aksident me vdekje në aksin Laç-Mamurras, mjeti del nga rruga, ndërron jetë shoferi! Një i plagosur
26 Mars, 08:34

Qëlluan me armë zjarri para banesës së një personi vetëm se u kërkoi të mos xhironin gomat e makinës, shpallen në kërkim dy adoleshentët në Lezhë (EMRAT)
25 Mars, 19:58

Berisha thirrje simpatizantëve demokratë në Kurbin: Mos bëni gabim të shkoni pas Alibeajt! Nuk përkulemi para pengjeve të Ramës
25 Mars, 19:13

Jetojnë në mes të ujërave të zeza, banorët e pallatit nr.10 në Lezhë ngrihen në protestë: Shkarkohen nga banesat private, bashkia të gjejë zgjidhje

Elvis Hila

25 Mars, 12:59

VIDEO/ Digjen mbetje poshtë urës në lumin e Drojës, shtëllungat e tymit mbulojnë autostradën dhe zonën në Fushë-Mamurras
25 Mars, 11:14

Aksident rrugor në aksin Tiranë-Lezhë, përplasen dy mjete, shoqërohen drejtuesit
24 Mars, 20:53

Punonjësit e portit te Shëngjinit sërish në protestë! Nuk janë paguar prej 3 muajsh, kërkojnë zgjidhje të problematikës

Elvis Hila

24 Mars, 11:02

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje